



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA E KOMBËTARE E AUDITIMIT**  
**NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE**

Në mbështetje të nenit 12.2 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe nenit 18, paragrafit 1.3 dhe 5 të Rregullores Nr. 01/2017 për Marrëdhënie Pune në ZKA, Zyra Kombëtare e Auditimit, me datën 9 mars 2018, publikon këtë:

**SHPALLJE**  
**për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta**

- I. Angazhim për shërbime:** Një Përkthyes: Gjuhë Shqipe - Serbe dhe anasjelltas  
**Numri i referencës:** P-MSHV/ZKA/04-03/18  
**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Përkthimi i memove/raporteve të auditimit, dokumenteve ligjore dhe të tjera, nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas.
- II. Angazhim për shërbime:** Një Përkthyes: Gjuhë Shqipe – Angleze dhe anasjelltas;  
**Numri i referencës:** P-MSHV/ZKA/05-03/18  
**Detyrat dhe përgjegjësitë:** Përkthimi i memove/raporteve të auditimit, dokumenteve ligjore dhe të tjera, nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas.

Angazhimi bëhet me kontratë për punë dhe detyrave specifike për një periudhë të caktuar kohore prej tre (3) muajve, duke filluar nga data 01 prill 2018 deri me datën 30 qershor 2018.

Për shërbimet e kryera të përkthimit, kompensimi bëhet në lartësinë e caktuar me aktet e brendshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

**Qëllimi i angazhimit:**

Përkthimi i memove/raporteve të auditimit, dokumenteve ligjore dhe të tjera, nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas si dhe përkthimi i memove/raporteve të auditimit, dokumenteve ligjore dhe të tjera, nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas.

**Kryerja e shërbimeve të përkthimit:**

Angazhimi kryhet sipas detyrave të përcaktuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e zbatueshme të njohura ndërkombëtarisht dhe nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të njesisë.

**Kushtet themelore:**

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte: Diplomë të shkollës së mesme, preferohet fakulteti; Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale në fushën e përkthimit; Preferohen trajnime në fushën relevante dhe kualifikime tjera profesionale

**Mënyra e konkurimit:**

Kandidatët e interesuar, aplikacionin zyrtar mund ta marrin në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit apo ta shkarkojnë nga ueb faqja e internetit në adresën: <http://www.zka-rks.org/> dhe mund të paraqesin dokumentacionin në kopje fizike në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në adresën: rr. "Musine Kokalari" nr.87- Prishtinë, të aplikojnë përmes faqes së internetit në adresën: [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ose përmes postës. Kandidatët, aplikacionit duhet bashkëngjitur dëshmitë për kualifikimin shkollor dhe përvojën e punës. Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Shpallja është e hapur pesë (5) ditë, nga dita e publikimit në faqen e internetit të ZKA-së dhe në shtypin ditor me datën 9 mars 2018 dhe mbetet e hapur deri më datën 14 mars 2018. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin për Burime Njerëzore, në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.